



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2643, datë 19.11. 2015

Për

**“Miratimin e dokumentit “Rregullore për Autorizimin e Përgjithshëm për Ofrimin e Shërbimeve Postare””**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Zj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Zj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Zj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 19.11.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Miratimin e dokumentit “Rregullore për Autorizimin e Përgjithshëm për Ofrimin e Shërbimeve Postare”.**

**BAZA LIGJORE:**

1. Neni 19, pika 2 dhe pika 8 të Ligjit Nr.46, datë 7.5.2015 “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 46/2015*);
2. Pika 3 e nenit 114 të Ligjit Nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (*ligji nr. 9918*);
3. Ligji Nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” i ndryshuar (*ligji nr. 8485*);
4. Udhëzuesi “Për procedurat e Këshillimit Publik”, miratuar me Vendim nr.1183, datë 10.03.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP

5. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendim nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

## K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit (*Relacioni*);
2. Dokumenti “Rregullore për Autorizimin e Përgjithshëm për Ofrimin e Shërbimeve Postare”;
3. Dokumenti “Qëndrimi i AKEP për komentet e dërguara gjatë këshillimit publik”;
4. Shkresa nr.3771, datë 06.11.2015, (Ref. AKEP: nr. prot. 1254/15, date 09.11.2015) e Ofruesit të Shërbimit Universal - Posta Shqiptare sh.a;
5. Komente të Ofruesit të Shërbimit Postar - DHL International Albania dërguar me email në adresën [info@akep.al](mailto:info@akep.al) në datë 09.11.2015 dhe datë 10.11.2015 (Prot. AKEP nr.1254/16, date 11.11.2015).
6. Projekt vendimi i formatuar dhe arsyetuar,

Si dhe duke j’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

## V Ë R E N:

1. Ligji Nr. 46/2015, 2015 “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë” është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë më datë 7.05.2015. Ky ligj zëvendëson Ligjin nr. 8530, datë 23.9.1999, “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Pika 2 e nenit 65, e ligjit 46/2015 citon: “Ngarkohet AKEP-i që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 12, pika 1; 14, pika 4; 16, pika 1; 19, pikat 2 dhe 8 ; 31, pika 5; 33, pika 1; dhe 55, pika 6, të këtij ligji”.
3. Bazuar në përcaktimet e ligjore të mësipërme, AKEP me Urdhërin nr. 1482, datë 23.06.2015, ngriti një Grup Pune (GP) për përgatitjen e kuadrit rregullator të shërbimeve postare sipas Ligjit 46/2015. Grupi i Punës përgatiti “Rregullore për Autorizimin e Përgjithshëm për Ofrimin e Shërbimeve Postare” për këshillim publik me palët e interesuara. Dokumenti i përgatitur ka si objekt të krijojë kuadrin rregullator për përmbushjen e kërkesave ligjore të nenit 19 pika 2 dhe pika 8, të Ligjit 46/2015.
4. AKEP me Vendimin nr. 2621, datë 08.10.2015 miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “Rregullore për Autorizimin e Përgjithshëm për Ofrimin e Shërbimeve Postare”. Dokumenti u publikua në faqen e internetit të AKEP dhe këshillimi publik u krye në periudhën 08.10.2015 deri 08.11.2015.
5. Në fund të procesit të këshillimit publik, AKEP depozitoi komente për palët e interesuara nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar - Posta Shqiptare sh.a. me shkresën nr.3771, datë 06.11.2015, (Ref. AKEP: nr. prot. 1254/15, datë 09.11.2015) dhe Ofruesit të Shërbimit Postar - DHL International Albania dërguar me email në adresën [info@akep.al](mailto:info@akep.al) në datë 09.11.2015 dhe datë 10.11.2015 (Prot. AKEP nr.1254/16, date 11.11.2015).
6. Grupi i Punës i ngritur në AKEP ka shqyrtuar dhe marrë në konsideratë sipas rastit komentet e palëve të interesuara, te cilat janë paraqitur në dokumentin Qëndrimi i AKEP

mbi komentet e dërguara për dokumentin e nxjerrë në këshillim publik, duke reflektuar ndryshime në dokumentin përfundimtar “Rregullore për Autorizimin e Përgjithshëm për Ofrimin e Shërbimeve Postare”.

7. Dokumenti përfundimtar i përgatitur pas këshillimit publik “Rregullore për Autorizimin e Përgjithshëm për Ofrimin e Shërbimeve Postare”, synon të plotësojë kuadrin ligjor dhe përmban përcaktime në lidhje me:
  - Shërbimet dhe objektet postare që kryen sipas kësaj Rregulloreje, të cilat ofrohen jashtë kushteve të shërbimit universal;
  - Procedura e njoftimit dhe regjistrimit për t’u pajisur me Autorizim të Përgjithshëm;
  - Kushtet e përgjithshme të ofrimit të shërbimeve që nuk bëjnë pjesë në shërbimin universal postar, nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm;
  - Standardet e cilësisë të ofrimit të shërbimeve postare që nuk bëjnë pjesë në shërbimin universal postar.
8. Dokumenti është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor përkates dhe ka marrë në konsideratë përvojën në vendet e BE dhe rajonit si dhe kushtet shqiptare në ofrimin e shërbimit postar.

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të dokumentit të cituar me lart, bazuar në pikën 4 të nenit 9, të ligjit 46/2015,

### **V E N D O S:**

1. Të miratojë dokumentat:
  - a) Rregullore për Autorizimin e Përgjithshëm për Ofrimin e Shërbimeve Postare;
  - b) Qëndrimi i AKEP mbi komentet e dërguara për dokumentin e nxjerrë në këshillim publik.
2. Ky vendim dhe dokumentat e miratuar, të publikohen në faqen e internetit të AKEP [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R**

**Piro XHIXHO**

### **ANËTARË:**

1. Alban KARAPICI
2. Anila DENAJ
3. Ketrin TOPÇIU
4. Klarina ALLUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

**R R E G U L L O R E**

**Nr. \_\_\_\_ DATË 19.11.2015**

**PËR**

**“AUTORIZIMIN E PËRGGJITHSHËM**

**PËR**

**OFRIMIN E SHËRBIMEVE POSTARE”**

*Miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.2643, Datë 19.11.2015*

## **KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 1 Objekti**

Kjo Rregullore, përcakton procedurat dhe kushtet e ofrimit të shërbimeve postare që nuk bëjnë pjesë në shërbimin universal postar në Republikën e Shqipërisë, nën Regjimin e “Autorizimit të Përgjithshëm”, në zbatim të ligjit Nr.46, datë 7.5.2015 “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”.

### **Neni 2 Qëllimi**

AKEP, nëpërmjet kësaj Rregulloreje, vendos rregulla për të gjithë ofruesit e shërbimeve postare që dëshirojnë të ofrojnë shërbime postare nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm, në Republikën e Shqipërisë.

### **Neni 3 Baza ligjore**

Neni 19, pika 2 dhe pika 8 të ligjit Nr.46, datë 7.5.2015 “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”.

### **Neni 4 Termet dhe Përkufizimet**

Përveç sa parashikohet në Ligjin 46/2015, termet e mëposhtme kanë këto kuptime:

1. **Adresa:** Çdo grup shenjash në një objekt postar që tregojnë marrësin dhe pikën e dorëzimit të objektit postar. Adresimi i dërgesave postare do të rregullohet më hollësisht në termat dhe kushtet e përgjithshme të ofruesve të shërbimeve postare;
2. **CEN:** Komiteti Evropian i Standardeve.
3. **DPS:** Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) e Republikës së Shqipërisë;
4. **Kod postar:** Është një mjet identifikues dhe element themelor e një adrese postare, dhe përmban informacionin e nevojshëm për vijimin e objektit postar deri në dorëzimin e tij. Ai është i përbërë nga 4 karaktere numerike.
5. **Postë direkte:** Janë objekte postare me natyrë komerciale, që i dërgohen në të njëjtën kohë një numri të madh klientësh të mundshëm nëpërmjet postës, dhe për të cilat dërgimi në adresën e banimit apo të vendit të punës nuk është i detyrueshëm.
6. **Postë hibride:** Posta hibride është një shërbim postar me bazë elektronike, nëpërmjet të cilit dërguesi e poston mesazhin ose në formë fizike ose në formë elektronike, i cili më pas përpunohet në mënyrë elektronike dhe shndërrohet në objekt postar për t’u dërguar fizikisht tek marrësi.
7. **Postë me shumicë:** Është posta që konsiston në dërgimin e një sasive të madhe objektësh postare identike (letra të së njëjtës natyrë ose reklama) që dërgohen në adresa individuale me çmim më të lire se tarifatat standarde, për të cilat pagesa kryhet në total.

8. **Shërbimi i shkëmbimit të dokumenteve:** Shërbimi që ofron mjetet, duke përfshirë ofrimin e ambjenteve për depozitim nga ana e dërguesit dhe marrjen nga ana e të adresuarit, të dy të abonuar në këtë shërbim, të objekteve postare.
9. **Zyrë postare:** Është një ambient biznesi i përdorur nga ofruesi i shërbimit postar apo nënkontraktorët e tij për të ofruar shërbimet postare.
10. **Dokument Shoqërues i objektit postar:** Është dokument që shoqëron një objekt postar nga pranimi deri në dorëzim. Gjithashtu si term i njohur me emërtimin Fature Shoqëruese dhe nderkombëtarisht Ëay Bill ose Air Ëay Bill, shkurtimisht AËB. Përmban të dhënat e kërkuara e të lidhura me objektin postar. Përgjegjës për plotësimin korrekt të këtij dokumenti është dërguesi.
11. **Termet dhe Kushtet e Transportit:** Ofruesi i shërbimit postar, në kushtet dhe termet e përgjithshme të transportit përcakton rregullat kryesore për tu ndjekur nga përdoruesi referuar doganave, eksportit dhe importit. Përcakton rregullat dhe mallrat të papranueshme në transport si dhe rregullat në rastet kur objekti postar nuk mund të dorëzohet në destinacionin e mbërritur. Përcakton rregullat e inspektimit të objektit postar, mënyra e llogaritjes së pagesës për transportin, si edhe përgjegjësitë dhe limitet e përgjegjësisë të ofruesit të shërbimit postar.

#### **Neni 5 Fusha e Zbatimit**

1. Detyrimi për zbatimin e kësaj rregulloreje ekziston në të gjithë rastet kur personat fizik/juridik, për qëllime fitimi, parashikojnë të ofrojnë shërbime postare që nuk plotësojnë kushtet specifike të ofrimit të shërbimit universal postar.

#### **Neni 6 Autorizimi i Përgjithshëm**

1. E drejta për të ofruar shërbime postare, kur ofrimi i shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë bëhet jashtë kushteve të shërbimit universal postar, bëhet përmes Autorizimit të Përgjithshëm, me njoftim.
2. Autorizimi i Përgjithshëm vendos termet dhe kushtet që duhet të respektojnë çdo sipërmarrës që dëshiron të ofrojë shërbime postare. Ai mbulon të gjithë ose pjesë të proceseve të pranimit, përpunimit, transportimit, shpërndarjes dhe dorëzimit të objekteve postare.

## **KREU II SHËRBIMET DHE OBJEKTET POSTARE**

#### **Neni 7 Shërbimet Postare**

1. Shërbimet postare që kryhen sipas kësaj Rregulloreje janë të gjitha shërbimet që ofrohen jashtë kushteve të shërbimit universal:

- a. Shërbimi i pranimit, përpunimit, transportit dhe shpërndarjes të objekteve postare të postës së shpejtë - Postë Expres, brenda vendit/me jashtë
- b. Shërbimi i pranimit, përpunimit, transportit dhe shpërndarjes të objekteve postare - Jo Expres, brenda vendit/me jashtë;
- c. Shërbimi i shpërndarjes së objekteve të paadresuara për publicitet;
- d. Shërbimi i shkëmbimit të dokumenteve;
- e. Shërbimi i dorëzimit të objekteve postare me shumicë;;
- f. Shërbimi i postës direkte;
- g. Shërbimi i postës hibride;
- h. Të tjera.

## **Neni 8**

### **Llojet e objekteve postare**

1. Objektet postare kur personat fizik/juridik të interesuar parashikojnë të ofrojnë shërbime postare që nuk bëjnë pjesë në shërbimin universal postar, përfshijnë:
  - a) objektet e korrespondencës,
  - b) pakot postare,
  - c) objektet e regjistruara,
  - d) objektet e siguruara;
  - e) dokumenta biznesi;
  - f) libra;
  - g) katalogë;
  - h) gazeta;
  - i) revista;
  - j) mallra me ose pa vlerë tregtare.

## **Neni 9**

### **Karakteristikat e objekteve postare**

1. Karakteristikat e objekteve postare do të përfshijë dimensionet, përmbajtjen, adresimin, paketimin dhe mbylljen.
2. Objektet e korrespondencës përmbajnë materiale të shkruara ose të shtypura, dhe pakot postare përmbajnë mallra.
3. Paketimi i objekteve postare do të thotë vendosja e përmbajtjes së objektit postar në paketimin e duhur, në përputhje me përmbajtjen e objektit postar, llojin e shërbimit të zgjedhur, kushtet dhe kohëzgjatjen e transportit. Dërguesi është përgjegjës për paketimin e përshtatshëm të objekteve postare.
4. Mbyllja e objekteve postare do të jetë e tillë që të mbrojë konfidencialitetin e përmbajtjes së objektit postar dhe të parandalojë qasjen në përmbajtjen e këtij objekti pa dëmtuar dukshëm paketimin. Dërguesi është përgjegjës për mbylljen e objekteve postare.
5. Adresa është informacioni që tregon qartë marrësin e objektit postar. Adresimi i objekteve postare do të thotë vendosja e adresës së marrësit në objektin postar ose në

dokumentin shoqërues së objektit postar. Në rast të objekteve postare që kërkojnë vërtetim/dokument të pranimit, dërguesi duhet të vendosë adresën e tij/saj në objektin postar në mënyrë të tillë që të mos mund të fshihet pa lënë gjurmë të dukshme në objektin postar. Dërguesi është përgjegjës për vendosjen e adresës së marrësit në mënyrë të qartë në objektin postar apo në dokumentin shoqërues të objektit postar. Dërguesi është përgjegjës për plotësimin e rregullt të dokumentacionit të kërkuar konform rregullave të transportit ndërkombëtar.

6. Ofruesi i shërbimit postar, në kushtet dhe termat e përgjithshme për ofrimin e shërbimit postar të publikuara prej tij, duhet të përcaktojë karakteristikat e objekteve postare që do të pranohen për transport, mallrat të papranueshme për transport, si dhe limitet e përgjegjësisë.
7. Ofruesi i shërbimit postar në kushtet dhe termat e përgjithshme të transportit duhet të përcaktojë karakteristikat e objekteve postare për transport ndërkombëtar, rregullat kryesore për tu ndjekur nga përdoruesi referuar doganave, eksportit dhe importit. Përcakton rregullat dhe mallrat të papranueshme në transport si dhe rregullat në rastet kur objekti postar nuk mund të dorezohet në destinacionin e mbërritur, si edhe limitet e përgjegjësisë.
8. Ofrimi i shërbimeve postare bëhet në përputhje me standardet e harmonizuara europiane dhe standardet ndërkombëtare për shërbimet postare, të përcaktuara nga UPU-ja dhe rregullave të përcaktuara në legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar për transportin e objekteve postare.

### **KREU III PROCEDURA E AUTORIZIMIT TË PËRGJITHSHËM**

#### **Neni 10 Procedura e Njoftimit**

1. Për të ofruar shërbime postare nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm (AP), përpara fillimit të ushtrimit të aktivitetit personi/at fizik ose juridik e intersuar duhet që të kryejnë procedurën e Njoftimit duke plotësuar një “Njoftim Regjistrimi” sipas formatit bashkëngjitur në Aneksin A.
2. Njoftimi i Regjistrimit paraqitet në AKEP duke plotësuar formularin e njoftimit online tek Moduli i Aplikimit Online për Autorizim të Përgjithshëm në faqen e ëeb të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al), në përputhje me modelin e Njoftimit të Regjistrimit të përfshirë në Aneksin A.
3. AKEP-i regjistron ofruesin e shërbimit brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit të plotë dhe të saktë, në bazën elektronike të të dhënave, dhe i konfirmon atij, me shkrim, kryerjen e regjistrimit.  
Nëse AKEP-i nuk konfirmon, brenda afatit të përcaktuar në pikën 3, të këtij neni, ose nuk informon personin fizik ose juridik për plotësimin e informacionit të munguar, njoftimi vlerësohet i plotë dhe regjistrimi përkatës quhet i kryer.
4. Kur informacioni për regjistrimin e një njoftimi nuk është në përputhje me kerkesat e përcaktuara në ligj dhe në këtë rregullore, AKEP brenda 7 (shtatë) ditëve nga depozitimi



ose aplikimit online, njofton të interesuarin për nevojën e plotësimit/saktësimit të informacionit. I interesuari duhet të paraqesë duke plotësuar me online tek Moduli i Aplikimit Online për Autorizim të Përgjithshëm, Njoftimin e Regjistrimit të plote brënda 15 ditëve nga data e njoftimit të AKEP. Nëse personi fizik ose juridik nuk e plotëson informacionin e munguar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, AKEP-i informon online personin fizik ose juridik se nuk do ta regjistrojë atë. Personi fizik ose juridik ka të drejtë të ankohet në Këshillin Drejtues të AKEP-it për këtë çështje brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit.

5. I interesuari i cili ka depozituar në AKEP duke plotësuar online një Njoftim Regjistrimi të plotë, dhe është pajisur me një çertifikatë konfirmimi nga AKEP, ka të drejtë të ushtrojë vetëm aktivitetin/t e përcaktuara në Çertifikatën e Konfirmimit të Njoftimit të lëshuar nga AKEP-i.
6. Ofruesit e shërbimeve postare që operojnë nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm, janë të detyruar të njoftojnë AKEP sipas të njëjtës procedurë, çdo ndryshim kur:
  - a) kërkohet të ofrohen shërbime postare të tjera, përveç atyre të deklaruara në Njoftimin e Regjistrimit fillestar;
  - b) kërkohet të mbyllë një ose disa shërbimet postare të vendosura më parë në Njoftimin e Regjistrimit dhe në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje;
  - c) ka pësuar ndryshim në të dhënat e regjistrimit ligjor, duke dërguar bashkëngjitur dokumentat që vertetojnë keto ndryshime;
  - d) bëhet ndonjë ndryshim në detaje të Njoftimit të Regjistrimit.Çdo ndryshim në të dhënat duhet të njoftohet brënda 30 ditëve nga ndodhja e tyre.
7. Formulari (Njoftimi i Regjistrimit) i plotësuar sipas pikës 2, nënshkruhet nga ofruesi i shërbimeve postare në momentin e tërheqjes së Certifikates së Konfirmimit të Njoftimit dhe i bashkëngjitet praktikës që arkivohet në AKEP së bashku me dokumentacionin shoqërues.
8. Nëse ofruesi i shërbimeve postare, brënda 30 ditëve nga njoftimi i AKEP nuk tërheq Çertifikatën e Konfirmimit të Njoftimit, AKEP-it i lind e drejta e kryerjes së procedurës së çregjistrimit të sipërmarrësit nga regjistri i sipërmarrësve”.

## **Neni 11**

### **Çertifikata e Konfirmimit të Njoftimit**

1. Çertifikata e konfirmimit të njoftimit vërteton se:
  - a) ofruesi i shërbimeve postare ka plotësuar një Njoftim Regjistrimi në formatin e duhur;
  - b) ofruesi i shërbimeve postare do ofrojë shërbime postare sipas zërave të plotësuar në Njoftimin e Regjistrimit, të konfirmuara nga AKEP;
  - c) ofruesi i shërbimeve postare do të zbatojë Kushtet e Përgjithshme të ofrimit të shërbimeve postare, të përcaktuara në këtë rregullore si dhe kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.
2. Forma dhe përmbajtja e Çertifikatës së Konfirmimit të Njoftimit përcaktohet sipas Aneksit B të kësaj Rregulloreje. Çertifikata do të printohet në dy kopje, një për ofruesin e shërbimeve postare dhe një kopje për AKEP.

## **Neni 12**

### **Regjistri i Ofruesve të Shërbimeve Postare**

1. AKEP administron Regjistrin e ofruesve të shërbimeve postare, bazë të dhënash të hapur për publikun dhe i përditesuar me ndryshimet e ndodhura. Regjistri i ofruesve të shërbimeve postare detyrimisht duhet të përmbajë këto të dhëna:
  - a) emrin dhe adresën e ofruesit;
  - b) të dhënat e regjistrimit ligjor të personit fizik ose juridik;
  - c) personat e kontaktit të personit fizik ose juridik;
  - ç) përshkrimin e shkurtër të shërbimit/eve dhe/ose rrjetit postar;
  - d) datën kur është parashikuar fillimi i ofrimit, ndryshimit dhe mbylljes së aktivitetit;
  - dh) tarifat e parashikuara për ofrimin e shërbimeve postare;
  - k) deklarin e zonës së ofrimit të shërbimeve postare.
2. AKEP publikon dhe përditëson në faqen e internetit Regjistrin e ofruesve të shërbimeve postare.

## **Neni 13**

### **Ndryshimi i autorizimit të përgjithshëm**

AKEP-i me vendim të Keshillit Drejtues ndryshon të drejtat, kushtet dhe procedurat për autorizimin e përgjithshëm në raste objektivist të justifikuara sipas percaktimit të nenit 21 të Ligjit 46/2015.

## **Neni 14**

### **Detyrimet e ofruesit të shërbimeve postare**

1. Ofruesit e shërbimeve postare nuk duhet të tejkalojnë deklarinet e bëra në Njoftimin e Regjistrimit, ose kushtet e përgjithshme sikurse parashikohen në këtë Rregullore dhe në ligjin Nr.46, datë 7.5.2015 “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”, dhe në aktet e tjera.
2. Kontrolli, mbikqyrja dhe Inspektimi i veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve postare kryhet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.46, datë 7.5.2015 “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”, dhe aktet nënligjore në fuqi.

## **Neni 15**

### **Mbyllja e veprimtarisë**

1. Kur ofruesi i shërbimeve postare vendos të mbyll veprimtarinë e njoftuar dhe të regjistruar nga AKEP, ai është i detyruar të njoftojë AKEP-in të paktën 30 ditë para fillimit të procedurave ligjore të mbylljes sipas formularit në Aneksin A. AKEP bën çregjistrimin e tij nga regjistri, vetëm pasi verifikon përmbushjen e detyrimeve ligjore të ofruesit të shërbimeve.
2. Në çdo rast dhe për çfarëdo lloj shkak ligjor, mbi të cilin ofruesi i shërbimit kërkon të bëjë mbylljen e aktivitetit, ai mbart detyrimin të njoftojë AKEP sipas parashikimit në pikën 1 të këtij neni.

**Neni 16**  
**Përditësimi i Regjistrit**

1. Ofruesit e shërbimeve postare që kanë pësuar ndryshim në të dhënat e regjistrimit, detyrohen të njoftojnë AKEP-in brënda 30 ditëve nga ndodhja e tyre, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Rregullore.
2. Procedura që duhet të ndiqet është në përputhje me parashikimet e kësaj Rregulloreje dhe brenda afateve të përcaktuara.

**Neni 17**  
**Çregjistrimi**

1. AKEP ç'regjiston një ofrues të shërbimeve postare nga regjistri i autorizimit të përgjithshëm në rastet:
  - a) kur ofruesi i shërbimeve postare kërkon të çregjistrohet;
  - b) kur deklaron mbylljen e veprimtarisë;
  - c) për shkelje të përsëritura të dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi, në përputhje me ligjin 46/2015, aktet nënligjore dhe ato rregullatore.

**KREU IV**

**KUSHTET E PËRGJITHSHMETË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE POSTARE**

**Neni 18**  
**Kërkesa të përgjithshme**

1. Ofruesit e shërbimeve postare që operojnë nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm, janë të detyruar të bashkëpunojnë me AKEP, sa herë që i kërkohet sipas parashikimeve të kësaj Rregulloreje, të Ligjit Nr. 46, datë 7.5.2015 "Për ofrimin e shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë", dhe në bazë të rregullimeve të tjera të ligjeve të aplikueshëm, në fuqi. Ndër të tjera, bashkëpunimi duhet të lejojë dhe asistojë AKEP, për kontrollin e zbatimit të kërkesave të Ligjit 46/2015 dhe akteve rregullatore të nxjera nga AKEP-i për shërbimin postar.
2. Ofruesit e shërbimeve postare duhet të depozitojnë në AKEP të dhënat statistikore dhe financiare të përditësuara sipas kërkesave dhe afateve të përcaktuara në rregulloren përkatëse të nxjerë nga AKEP-i, informacione të kërkuara dhe hollësi të tjera lidhur me aktivitetet të cilat janë objekt i regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare.

**Neni 19**  
**Shërbimet postare ekspres**

1. Shërbimet postare ekspres do të konsiderohen shërbime postare që nuk bëjnë në pjesë në shërbimin universal postar.

“Shërbim ekspres” është shërbimi i shpërndarjes “derë me derë”, në një kohë të shkurtër, shpërndarjes një ditë pas dorëzimit, ose transportit në kohë të përcaktuar të objektit postar që përfshin shpërndarjen e dokumenteve, pakove dhe mallrave.

2. Një shërbim postar do të konsiderohet si shërbim ekspres atëhere kur plotëson kërkesat e mëposhtme:
  - a) Shpërndarja dhe dorëzimi standard i një objekti postar të postës së brendëshme në rastin kur dërguesi dhe marrësi janë brenda territorit të Shqipërisë duhet të bëhet ditën tjetër të punës pas pranimit të objektit postar. Ofruesi i shërbimit postar duhet të ketë të publikuar kohën tranzite të dorëzimit sipas vendeve, përfshirë edhe kohën tranzite të dorëzimit në vendet ku dorëzimi nuk realizohet brenda ditës tjetër të punës.  
Koha standard e dorëzimit e publikuar matet për rastet kur dorëzimi është i mundshëm dhe nën kontrollin e ofruesit të shërbimit postar. Ofruesi i shërbimit postar duhet të përcaktojë rastet e pamundësisë të dorëzimit të objektit postar brenda kohës të përcaktuar, të cilat i publikon në Termat dhe Kushtet e Përgjithshme të ofrimit të shërbimit postar.
  - b) Shpërndarja dhe dorëzimi i një objekti postar në rastin kur dërguesi është jashtë territorit të Shqipërisë dhe marrësi brenda territorit të Shqipërisë duhet të bëhet brenda ditës tjetër të punës, pas mbritjes së tij në Republikën e Shqipërisë.  
Koha standard e dorëzimit matet për rastet kur dorëzimi është i mundshëm dhe nën kontrollin e ofruesit të shërbimit postar. Ofruesi i shërbimit postar duhet të përcaktojë rastet e pamundësisë të dorëzimit të objektit postar brenda kohës të përcaktuar, të cilat i publikon në Termat dhe Kushtet e Përgjithshme të ofrimit të shërbimit postar.  
Ditët e pushimit javor si edhe ditët e pushimit të festave zyrtare sipas shteteve apo festave lokale në vendin e destinacionit apo origjines nuk llogariten në kohën e dorëzimit.
  - c) Shërbimi postar është identifikuar në mënyre të qartë si shërbim postë-ekspres nga pranimi deri në dorëzim të objektit postar, i përfshirë në Termat dhe Kushtet e shërbimit.
  - d) Shërbimi ekspres përmban një kohë të paracaktuar të dorëzimit.
  - e) Shërbimi ekspres ndërkombëtar përmban një kohë të përcaktuar dhe të publikuar të dorëzimit sipas produktit apo llojit të shërbimit. Koha e dorëzimit duhet të jetë e publikuar dhe lehtësisht e aksesueshme për publikun në pikat e pranimit të dërgesave. Koha tranzit e dorëzimit matet me ditë pune sipas shteteve të destinacionit në rastin e eksportit apo shteteve të origjinës në rastin e importit.  
Koha standard e dorëzimit është për të gjitha rastet kur dorëzimi është i mundshëm dhe nën kontrollin e ofruesit të shërbimit postar.
  - f) Shërbimi postar përmban trajtimin e prioritetive, ndjekjen dhe kontrollin menaxherial.
  - g) Lejimin e gjurmimit dhe ndjekjes elektronike të objektit postar nga përdoruesi i shërbimit “end-to-end” si për objektet postare brenda vendit ashtu edhe për ato jashtë vendit. Gjurmimi duhet të jetë i plotë nga momenti i pranimit deri në momentin e dorëzimit apo edhe rastet kur shërbimi për objektin postar konsiderohet i plotësuar.

- h) Ofruesi i shërbimit postar duhet të ketë të publikuara dhe të aksesueshme lehtësisht për publikun, minimalisht në zyrat e tij të pranimit të objekteve postare, produktet dhe shërbimet standard të shërbimit ekspres, kohën e përcaktuar të dorëzimit si edhe çmimet përkatëse.
- Ofruesi i shërbimit postar ekspres duhet të publikojë përshkrimin dhe pagesat përkatëse shtesë që bëhen mbi pagesat për çmimin e shërbimit standard ekspres të cilat janë të lidhura me karakteristika të veçanta të objekteve postare që kërkojnë trajtim të veçantë administrativ dhe përpunues, shërbime për destinacione apo origjina të veçanta, si edhe pagesa për kosto shtesë të veçanta.
- i) Shërbime të tjera me vlerë të shtuar mbi ato shërbime që përfshihen në shërbimin standard ekspres, duke përfshirë mundësinë e një çmimi premium sipas llojit të shërbimit me vlerë të shtuar.
- j) Në qoftë se një ofrues i shërbimit postar është i mendimit se megjithëse shërbimi që dëshiron të ofrojë nuk përfshihet në përcaktimet e mësipërme të shërbimit postë-eksres, por ai mund të konsiderohet se nuk bën pjesë në shërbimin universal postar, mund të dërgojë argumentat e tij të detajuara në AKEP për shqyrtim. AKEP, bazuar në përcaktimet e ligjore dhe ato rregullatore, shprehet në se ky shërbim është ose jo shërbim postë-eksres.

## **Neni 20**

### **Shërbimet postare me vlerë të shtuar**

1. Shërbimet ekspres me vlerë të shtuar janë ato shërbime të cilësuar si vlerë e shtuar për përdoruesin.
2. Ofruesi i shërbimit postar duhet të ketë të publikuara dhe të aksesueshme lehtësisht për publikun, minimalisht në zyrat e tij të pranimit të objekteve postare, produktet dhe shërbimet me vlerë të shtuar të shërbimit ekspres si edhe çmimet përkatëse.
3. Shërbimet me vlerë të shtuar mund të përfshijnë një ose disa nga shërbimet e mëposhtëme:
  - a) Dorëzim brenda një ore të ditës të përcaktuar dhe me Garanci për Kthimin e Pagesës Shtesë në rast mosrealizimi sipas kushteve të përcaktuara, të tilla si Përpara orës 9:00, Përpara orës 10:00, Përpara orës 12:00.
  - b) Tërheqje apo dorëzim të objektit postar në ditët e pushimit.
  - c) Siguracion i objektit postar. Siguracioni bëhet për një mbulim të plotë të vlerës në rast humbje apo dëmtimi të objektit postar sipas vlerës së deklaruar dhe kushteve të sigurimit të objektit postar.
  - d) Tërheqje apo dorëzim i dedikuar kur objekti postar ka specifika të përcaktuara dhe shërbimi normal nuk është i mjaftueshëm.

- e) Paketimi. Paketim brenda një game standarte të paketimit të ofruesit të shërbimit.
- f) Administrimi dhe pagesa e detyrimeve të taksave e tatimeve nga ofruesi i shërbimit për lehtësi të dërguesit, apo një pale të tretë, kur sipas termave të tregëtimit nuk i janë lenë marrësit për të paguar, apo në rastet kur marrësi për lehtësi administrimi ngarkon ofruesin e shërbimit për të paguar.
- g) Terheqje apo dorëzim vonë. Shërbim i kërkuar jashtë orarit standart, jo të zakonshëm të punës.
- h) Firma e dorëzimit. Kur përdoruesi kërkon nga ofruesi i shërbimit një kopje të firmës së marrësit të objektit postar të dërguar në mënyrë elektronike apo kopje të printuar si provë e dorëzimit të dërgesës në destinacion.
- i) Trajtimi dhe transportimi i substancave dhe mallrave të klasifikuara si të rrezikshme në transportin ajror apo tokësor sipas përcaktimeve të organizatave botërore përkatëse.
- j) Shërbime doganore apo administrim të shërbimeve dhe dokumentacionit doganor.
- k) Garancia e dorëzimit të objektit postar në një datë të caktuar;
- l) Dorëzimi i dërgesave postare “Personalisht” tek marrësit;
- m) Mundësi për të ndryshuar adresën e destinacionit dhe rrugën që do të ndiqet për dorëzimin e dërgesës postare;
- n) Shërbim i personalizuar për klientin.

## **Neni 21**

### **Respektimi i zonës së rezervuar**

Ofruesit e shërbimeve postare gjatë veprimtarisë së tyre duhet të respektojnë zonën e rezervuar për ofrimin e shërbimeve postare në lidhje me pranimin, përpunimin, transportin dhe dorëzimin e objekteve të korrespondencës së brendshme, me çmim dhe kufi peshe, siç përcaktohet në aktet nën-ligjore përkatëse.

## **Neni 22**

### **Kërkesat për ofrimin e shërbimeve postare**

Kushtet për ofrimin e shërbimeve postare do të rregullohen në përputhje me Ligjin për shërbimet postare, këtë rregullore dhe termat dhe kushtet e përgjithshme të përgatitura nga ofruesi i shërbimit postar.

## **Neni 23**

## Kërkesat thelbësore për ofrimin e shërbimit postar

Ofruesit e shërbimit postar, që ofrojnë shërbime postare nën regjimin e autorizimit të përgjithshëm, janë të detyruar të përmbushin kërkesat thelbësore ligjore, të percaktuar në nenin 20, pika 1 e ligjit 46/2015, si dhe veçanërisht duhet të garantojnë:

- a) Ofruesit e shërbimeve postare duhet të marrin masat e nevojshme në lidhje me konfidencialitetin e korrespondencës, si dhe të përcaktojnë sipas legjislacionit në fuqi:
  - Kërkesat/kushtet e paketimit të objekteve postare (të përshtatshme për peshën, formën, llojin – natyrën e objektit, të thyeshme, materiale biologjike, radioaktive, të çmuara, etj...);
  - Të drejtat dhe detyrimet e organeve/personave që konform ligjit kanë të drejtë t'i hapin objektet postare në rastet:
    - Kur ato janë të dëmtuara në mënyrë të tillë që të ripakëtohen për t'u mbrojtur nga dëmtimi i mëtejshëm;
    - Kur dyshohet për materiale apo substanca të ndaluara;
    - Kur ka një urdhër të lëshuar nga organet kompetente.

Hapja, shkatërrimi, shpërndarja e këtyre objekteve postare duhet të bëhet sipas rregullave/procedurave të përcaktuara nga ofruesi i shërbimeve postare dhe legjislacionit në fuqi;

- b) Sigurinë, integritetin dhe mirëmbajtjen e funksioneve të rrjetit postar me qëllim funksionimin e tij edhe në situata të jashtëzakonshme;
- c) Mos lejimin e dërgimit të objekteve të ndaluara me ligj ose të konsideruara të rrezikshme në bazë të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar ose që, për natyrën e tyre ose ambllazhimin, mund të përbëjnë një dëm mbi njeriun, ambjentin ose për pakot e tjera që janë për tu transportuar sipas rregullave të organizatave ndërkombëtare.
- d) Ofruesi i shërbimit postar duhet të marrë masat për zbatimin e detyrimeve ligjore sa i takon termave dhe kushteve të punësimit në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;
- dh) Ofruesi i shërbimit postar duhet të marrë masat për zbatimin e detyrimeve ligjore sa i takon termave dhe kushteve të sigurimit shoqëror e shëndetësor të të punësuarve në përputhje me ligj nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe ligjin nr.10 383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- e) Respektimin e marrëveshjeve kolektive të hartuara sipas “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, në mbrojtjen e të drejtave të punësuarve;
- f) Ofruesit e shërbimeve postare gjatë ofrimit të shërbimit duhet të kujdesen për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të privatësisë gjatë proceseve të përpunimit, komunikimit, transmetimit apo përhapjes së këtyre të dhënave, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. Nr. 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar;
- g) Marrjen e masave të posacme për mbrojtjen e mjedisit, sa i takon reduktimit të sasisë së mbeturinave dhe mundësia e riciklimit të tyre etj, kursimi dhe përdorimi me efikasitet të energjisë etj;

Në rastet kur kërkohet të ngrihet infrastruktura e posaçme, ngritja e ndërtesave apo instalimi i pajisjeve, sipërmarrësit janë të detyruar të marrin lejet dhe miratimet sipas rregullave dhe ligjeve të posaçme për këtë qëllim;

- h) Ofruesi i shërbimit postar harton një plan veprimi për sigurimin e ofrimit të shërbimit postar në rastin e situatave të jashtëzakonshme, të cilin ia paraqet AKEP-it. Me situatë të jashtëzakonshme kuptohet dëmtimet e rënda të rrjetit, fatkeqësitë natyrore, gjendjen e emergjencës ose gjendjen e luftës.

#### **Neni 24**

##### **Tarifat dhe ndarja e llogarive**

1. Tarifat për çdo shërbim që bën pjesë në shërbimin postar duhet të përmbushin parimet e mëposhtme:
  - a) të jenë të orientuara drejt kostos dhe të sigurojnë nxitje për ofrimin efikas të shërbimit postar;
  - b) të jenë transparente dhe jodiskriminuese, të mos dëmtojnë konkurrencën.
2. Tarifat për shpërndarjen e objekteve postare që vijnë nga jashtë vendit përcaktohen në bazë të marrëveshjeve dypalëshe ose shumë palëshe midis ofruesit të shërbimit dhe ofruesve përkatës të shërbimeve postare nderkufitare.
3. Ofruesi i shërbimit postar duhet të mbajë llogari të ndara për të dalluar, në mënyrë të qartë, shërbimet dhe produktet që janë pjesë e shërbimit postar dhe ato që nuk janë pjesë e këtij shërbimi, me qëllim llogaritjen e pagesës së mbikqyrjes së tregut dhe treguesve të tjerë sipas kërkesave të ligjit 46/2015.

#### **Neni 25**

##### **Termat dhe kushtet e përgjithshme të ofrimit të shërbimeve postare**

1. Ofruesit e shërbimeve postare hartojnë termat dhe kushtet e përgjithshme të ofrimit të shërbimeve postare sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm. Termat dhe kushtet e përgjithshme duhet të përmbajnë informacionin e specifikuar në pikën 1 të nenit 32 të ligjit 46/2015, si dhe standardet dhe cilësinë e shërbimit, rregullat për postimin nga përdoruesi të objekteve postare dhe shpërndarjen e tyre nga ofruesit e shërbimeve postare.
2. Termat dhe kushtet e përgjithshme të hartuara nga ofruesit e shërbimeve postare, i dërgohen AKEP-it për shqyrtim 30 ditë para aplikimit të tyre dhe AKEP ka të drejtë të kërkojë apo imponojë ndryshimin e tyre nëse ato nuk janë në përputhje me kërkesat e Ligjit 46/2015 dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.
3. Termat dhe kushtet e përgjithshme të shërbimeve postare publikohen në faqen zyrtare të internetit. Ofruesit e shërbimeve postare duhet të mbajnë kopje fizike në format të printuar dhe lehtësisht të lexueshëm të termave dhe kushteve të përgjithshme në zyrat postare të tyre për t'i bërë të disponueshme për përdoruesin ose për t'i dërguar në adresën e përdoruesit postar nëse kjo kërkohet prej tij.



**Neni 26**  
**Rrjeti Postar i ofruesit të shërbimit postar**

1. Pjesët përbërëse të rrjetit postar janë pikat e aksesit, qendrat postare të përpunimit dhe elementët e tjerë në funksion të sigurimit të ofrimit të shërbimeve postare.
2. Pikat e aksesit të rrjetit postar:
  - zyrat postare,
  - qendrat e përpunimit,
  - pikat e vetë-shërbimit,
  - kutitë postare, dhe
  - pajisje dhe fasilite të tjera që shërbejnë për pranimin e dërgesave postare.
3. Ofruesi i shërbimit postar duhet të krijojë, mirëmbajë dhe zhvillojë një rrjet postar për të siguruar ofrimin e shërbimit postar në zonën e autorizuar në mënyrën e percaktuar në Ligjin për shërbimin postar dhe në këtë Rregullore.
4. Dendësia e pikave të aksesit dhe orari i punës së zyrave postare përcaktohet nga vetë ofruesi i shërbimit në plotësim të kërkesave të ligjit 46/2015, në bazë të nevojave të përdoruesve të shërbimeve postare dhe kërkesave të biznesit.
5. Në rrjetin postar mund të vendosen vetëm pajisje që kanë karakteristika teknike, sipas standardeve të harmonizuara e të miratuara nga organizmat ndërkombëtarë, ku Republika e Shqipërisë aderon.

**Neni 27**  
**Standardet e cilësisë së ofrimit të shërbimit postar**

1. Ofrimi i shërbimeve postare duhet të realizohet në përputhje me standardet europiane dhe ato botërore për shërbimet postare, si dhe me standardet e percaktuara nga AKEP në këtë rregullore.
2. Standardet e cilësisë për shërbimin postar brenda vendit të ofruar nga ofruesi i shërbimit postar do të jenë:
  - a) Standardet e cilësisë së shërbimeve postare ekspres – postë brenda vendit

<b>Detyrimet e cilësisë së shërbimeve postare ekspres – brenda vendit</b>			
Brenda për brenda qytetit/ Ndërmjet qyteteve		Në zonat rurale	
Koha e dorëzimit	Objekte postare të dorëzuara	Koha e dorëzimit	Objekte postare të dorëzuara
<b>D + 1</b>	<b>95 %</b>	<b>D + 2</b>	<b>5 %</b>

Për dërgesat ekspres të postës së jashme mund merren në konsideratë standardet e cilësisë së shërbimit postar të ofruesve të shërbimit postar me të cilat është lidhur marrëveshje.

*Shënime për tabelen në piken 2:*

- Objektivat e mësipërm të cilësisë janë për objektet postare me kohë më të shpejtë shpërndarjeje.

- *D: data e depozitimit (pranimit) të objektit postar në (nga) ofruesi i shërbimit postar.*
  - *n: numri i ditëve të punës (përfshihen ditët e pushimit dhe festat zyrtare) që duhen për shpërndarjen e objektit nga data e pranimit deri në datën e dorëzimit tek i adresuari.*
3. Ofruesi i shërbimit postar ka detyrimin e plotësimit të standardeve të mëposhtme të shërbimit postar të CEN të transpuzuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) e Shqipërisë:
- a. **S SH EN 13850:2012:** Shërbimi postar – Cilësia e shërbimit – Matja e kohës së tranzitit të shërbimeve nga fillimi në fund (end-to-end) për pjesë të veçanta të dërgimit prioritar me postë dhe dërgimi me postë i klasit të parë;
  - b. **S SH EN 14508:2006:** Shërbimet postare - Cilësia e shërbimit - Matja e kohës tranzite nga fillimi në fund i shërbimit për një pjesë jo prioritare të dërgimit me postë dhe dërgimi me postë i klasit të dytë;
  - c. **S SH EN 14534:2006:** Shërbimet postare - Cilësia e shërbimit - Matja e kohës tranzite nga fillimi në fund i shërbimit për dërgesat me postë me grumbuj të pa ambalazhuar.

## **Neni 28 Të drejtat**

Autorizimi i përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare, i jep të drejtë subjektit të autorizuar:

- a) Ofruesi i shërbimeve postare i autorizuar nga AKEP-i për të ofruar shërbime postare nën regjimin e autorizimit të përgjithshëm, ka të drejtë të kërkojë akses në rrjetin postar të ofruesit të shërbimit universal, në përputhje me parimet e mosdiskriminimit dhe transparencës, kurdohere dhe kudo që të jetë e mundur.
- b) Procedura e kërkesës dhe dhënies së aksesit përcaktohet në Rregulloren për Ofrimin e Shërbimit Universal Postar.
- c) Të marrë pjesë në procedurën e përcaktimit si ofrues i shërbimit universal postar, për shërbime të veçanta, në skemën e shërbimit universal postar, ose në pjesë të caktuara të territorit të Republikës së Shqipërisë.

## **Neni 29 Publikimi**

1. Ofruesi i shërbimit postar publikon në faqen e internetit informacionet që lidhen me shërbimin postar që nuk bën pjesë në shërbimin universal sipas kërkesave të ligjit 46/2015, akteve rregullatore duke përfshirë dhe informacion në lidhje me:
- a) zyrat postare dhe oraret e tyre;
  - b) tarifat dhe çmimet;
  - c) procedurat e reklamimit dhe të rimbursimit;
  - d) modalitetet e aksesit në shërbime;
  - e) standardet e cilësisë;
  - f) aksesin për gjurmimin e objekteve postare të brendshme dhe ndërkombëtare.

### **Neni 30**

#### **Pagesat dhe financimi**

1. Ofruesit e shërbimit postar janë të detyruar të paguajnë në AKEP një pagesë vjetore për të mbuluar kostot administrative respektive të AKEP-it për mbikëqyrjen e tregut postar.
2. Niveli i pageses për mbikëqyrjen e tregut të shërbimeve postare dhe kërkesat që duhet të plotësojnë ofruesit e shërbimeve postare për kryerjen e kësaj pagese përcaktohet sipas përcaktimeve të nenit 27 të Ligjit 46/2015, datë 07.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” dhe rregullave të nxjerra nga AKEP-i.
3. Në se AKEP, bazuar në verifikimin e kostove neto të tarifave, arrin në përfundimin se kostot neto për ofrimin e shërbimit universal përbëjnë një ngarkesë të padrejtë për ofruesin e shërbimit universal, përcakton rregullat, skemën dhe nivelin e detyrimit për financimin e shërbimit universal postar që duhet të bëjnë ofruesit e shërbimeve postare.

### **Neni 31**

#### **Ankesat**

1. Çdo ofrues i shërbimit postar është i detyruar të trajtojë ankesat e përdoruesve në lidhje me shërbimet postare që ofron. Nëse ankesa nuk zgjidhet nga ofruesi, përdoruesi ka të drejtë të ankohet pranë AKEP.
2. Ofruesi i shërbimeve postare duhet të publikojë, në faqen zyrtare të tij dhe në zyrat e ofrimit të shërbimit, rregullat për pranimin, trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të përdoruesve, sipas ligjit 46/2015 dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e konsumatorit.

### **Neni 32**

#### **Mosmarrëveshjet**

1. Mosmarrëveshjet ndërmjet ofruesve të tjerë të shërbimit postar në Republikën e Shqipërisë zgjidhen nga AKEP sipas përcaktimeve të nenit 56 të Ligjit 46/2015.
2. Mosmarrëveshjet ndërmjet ofruesit të shërbimit postar dhe përdoruesve të këtij shërbimi që lidhen me zbatimin e ligjit dhe të rregullave të nxjerra në zbatim të tij, zgjidhen nga AKEP-i sipas përcaktimeve të nenit 55 të ligjit 46/2015.

### **Neni 33**

#### **Detyrime të tjera**

1. Ofruesit e shërbimit postar konsiderohen përgjegjës për dëmet e shkaktuara gjatë transportimit të objekteve postare të regjistruara dhe siguruara dhe të kolipostave për të cilat duhet të zbatohet masën e demshpërblimit sipas përcaktimeve në nenin 49 të ligjit 46/2015.
2. Mallrat postare i nënshtrohen formaliteteve dhe kontrolleve të nevojshme doganore dhe mund të jenë objekt i tarifës doganore, tatimeve apo taksave të tjera që paguhet në import apo eksport, apo mund të jenë objekt i përjashtimit nga këto pagesa, sipas përcaktimeve në nenet 57 – 59 dhe legjislacionit në fuqi.

### **Neni 34 Inspektimi**

1. Për kontrollin e zbatueshmërisë së ligjshmërisë dhe kushteve të përcaktuara nga AKEP-i për ofrimin e shërbimeve postare, AKEP-i inspekton veprimtarinë e ofruesve postare në përputhje me ligjin nr. 46/2015.
2. Nëse AKEP evidenton se ofruesi i shërbimeve postare nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm nuk ushtron aktivitetin në përputhje me ligjin 45/2015, rregulloreve të nxjerra nga AKEP për shërbimin postar, termat dhe kushtet e përcaktuara në këtë Autorizim, AKEP mund të ndërmarrë veprimet dhe masat e nevojshme sipas dispozitave të parashikuara në ligjin 46/2015.

## **KREU V DISPOZITA TË FUNDIT**

### **Neni 35 Shfuqizimi**

Rregullorja Nr.21 datë 18.03.2011 “Për licencën e përgjithshme për ofrimin e shërbimeve postare” miratuar me Vendim Nr.1532, datë 18.03.2011, ndryshuar me Vendim Nr. 2253, datë 23.01.2013 të Këshillit Drejtues të AKEP, shfuqizohet.

### **Neni 36 Dispozitë kalimtare**

1. Dispozitat e kësaj Rregullore zbatohen për ofruesit e shërbimeve postare në trafikun postar kombëtar dhe ndërkombëtar, nëse nuk është rregulluar ndryshe në legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar.
2. Ofruesi i shërbimit postar duhet të marrë masa për të harmonizuar ofrimin e shërbimeve postare me dispozitat e kësaj rregulloreje, brenda 60 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.
3. Të gjithë ofruesit e shërbimit postar duhet që brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, të kryejnë njoftimet përkatëse në AKEP për autorizimin e përgjithshëm, sipas përcaktimeve të parashikuara në këtë rregullore.

### **Neni 37 Hyrja në Fuqi**

Kjo rregullore dhe Aneksat e saj, hyjnë në fuqi në datën e miratimit nga KD i AKEP-it dhe publikohet në faqen e internetit të AKEP.



**FORMULAR NJOFTIM REGJISTRIMI**  
**PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE POSTARE**  
**NËN REGJIMIN E AUTORIZIMIT TË PËRGJITHSHËM**

**Formulari i njoftimit dhe deklarimit të të dhënave për ofrimin e shërbimeve postare  
nën regjimin e autorizimit të përgjithshëm që sipërmarrësit  
duhet të plotësojnë dhe dërgojnë në AKEP**

<b>A - Informacion i sipërmarrësit që dërgon njoftimin</b>		
<b>1</b>	<b>Të dhëna mbi shoqërinë</b>	<b>Plotësimet</b>
1.1	Emri i personit fizik ose juridik sipas regjistrimit në QKR	
1.2	Emri tregtar <i>(në se është i ndryshëm)</i>	
1.3	Adresa postare	
1.4	NIPT	
1.5	Telefon	
1.6	E-mail	
1.7	Website	
1.8	Selia e shoqërisë	
1.9	Persona të tjerë fizik ose juridik që janë pjesë e sipërmarrjes	
<b>2</b>	<b>Përfaqësuesi ligjor</b>	
2.1	Emri i Përfaqësuesit Ligjor	
2.2	Numri personal sipas dokumentit të identifikimit-ID :	
	Autoriteti që e ka lëshuar	
2.3	Adresa	
2.4	Telefon	
2.5	E-mail	
<b>3</b>	<b>Personi i kontaktit</b>	
3.1	Emri i personit të kontaktit	
3.2	Numri i telefonit të zyrës	
3.3	Numri i telefonit mobile	
3.4	Numri i Telefoni i shërbimit / kujdesi për klientin	
<b>4</b>	<b>Fillimi/ndryshimi/mbyllja e veprimtarisë</b>	
4.1	Fillimi	Data __.__.____
4.2	Ndryshimi	Data __.__.____
4.3	Mbyllja	Data __.__.____
<b>5</b>	<b>Dokumentat që dërgohen bashkëngjitur njoftimit</b>	
5.1	Kopje e ekstraktit historik të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR).	
5.2	Kopje të letërnjoftimit/kartës së identitetit në se subjekti është regjistruar si person fizik.	
5.3	Deklaratën se zotëron kapacitete profesionale.	
5.4	Përshkrimi i shkurtër i rrjetit dhe/ose shërbimit/eve postare që kërkon të ofrojë.	
5.5	Tarifat e parashikuara për ofrimin e shërbimeve postare.	

**B - Të dhëna mbi Shërbimet Postare që nuk bëjnë pjesë në Shërbimin Universal Postar**

<b>Emri i Shërbimit Postar:</b>			
<b>Nr</b>	<b>Objekte postare dhe të dhëna të shërbimit</b>	<b>Po/Jo</b>	<b>Plotësime / sqarime</b>
1	Objekte të korrespondencës / dokumenta		
1.1	Dokumenta brenda vendit		
1.2	Dokumenta me jashtë (eksport)		
1.3	Dokumenta me jashtë (import)		
2	Jo dokumenta / Pako		
2.1	Jo dokumenta / Pako (eksport)		
2.2	Jo dokumenta / Pako (import)		
3	Objekte të regjistruara		
4	Objekte të siguruara		
5	Dokumenta biznesi		
6	Libra		
7	Katalogë		
8	Gazeta		
9	Revista		
10	Mallra me ose pa vlerë tregtare		
11	Të tjera ( <i>ju lutem specifikoni</i> )		
<b>12</b>	<b>Zona e ofrimit të shërbimit</b>		
12.1	Shtrirja gjeografike (e dërguesit)		
12.2	Shtrirja gjeografike (e marrësit)		
<b>13</b>	<b>Cilësia e shërbimit postar</b>		
13.1	Standardet e cilësisë së shërbimit		
13.2	Kufizimet e përmasave		
13.3	Kufizimet e peshës		
<b>14</b>	<b>Marrëveshjet e aksesit</b>		
14.1	Të depozituara në pikën e aksesit		
14.2	Të grumbulluara nga vendi i dërguesit		

**Shënim:** Ky formular plotësohet i veçantë për çdo shërbim që nuk bën pjesë në shërbimin universal postar që kërkon të ofrojë subjekti.  
Në faqen e fundit mund të jepen sqarime shtesë për të dhënat e Formularit - Pjesa B.

## DEKLARATA

### Deklaroj nën përgjegjësinë personale:

1	Nëpërmjet këtij dokumenti deklaroj se dëshiroj të ushtroj aktivitete të lart përmendura të shërbimit postar dhe kërkoj regjistrimin në regjistrin e ofruesve të shërbimeve postare të administruar nga AKEP.
2	Informacionet që përmban ky Njoftim Regjistrimi dhe çdo informacion tjetër që i bashkëlidhet këtij dokumenti, është i saktë dhe i vërtetë dhe si ofrues i shërbimeve postare do të ofroj shërbimet postare që nuk bejnë pjesë në shërbimin universal postar, të kërkuara në këtë Njoftim Regjistrimi dhe të konfirmuara nga AKEP në zbatim të detyrimeve të ligjit Nr.46, datë 7.05.2015 "Përshërbimet postare në Republikën e Shqipërisë", dhe Rregullores "Për Autorizimin e Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare".

Data \_\_\_\_.

**Përfaqësuesi ligjor**

.....  
Nënshkrimi & vula

### **Sqarime mbi dërgimin dhe/ose ndryshimin e të dhënave si dhe mbylljen e veprimtarisë**

Këtu jep një përshkrim analitik të dërgimit të të dhënave dhe/ose ndryshimeve të deklaruara si dhe mbyllja e veprimtarisë për të cilat kryhet depozitimi i deklaratës të cilës i bashkëlidhen vetëm dokumenta të domosdoshme për ndryshimet, apo të dhëna të tjera justifikuese. Në rast se nuk mjafton kjo faqe, bashkëlidhimi faqe shtesë.





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

---

**ÇERTIFIKATË**  
**E KONFIRMIMIT TË NJOFTIMIT**

Nr. \_\_\_\_ /datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_

**OFRUESI I SHËRBIMEVE POSTARE**  
**“XXXXXXXXXX”**

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare konfirmon se Ofruesi i Shërbimeve Postare “XXXXXXXXXX” me adresë: XXXXXXX, ka paraqitur Njoftimin e Regjistrimit sipas Nenit 19 të Ligjit Nr. 46 datë 7.05.2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë” dhe është regjistruar në Regjistrin e Ofruesve të Shërbimeve Postare për ofrimin e shërbimeve postare që nuk bëjnë pjesë në shërbimin universal postar sipas Regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm.

**K R Y E T A R**

\_\_\_\_\_  
(nënshkrimi & vula e autoritetit)

**Shërbime postare që nuk bëjnë pjesë në shërbimin universal postar të njoftuara në AKEP nga Ofruesi i Shërbimeve Postare “XXXXXXXX”**

**A. Shërbime Postare:**

**1. Shërbime postare që ofrohen:**

a) .....

b) .....

**B. Zona e ofrimit të shërbimeve postare:**

**1. Ofruesi i shërbimeve postare duhet të ofrojë shërbimet postare brënda territorit:**

**Bashkitë:**

-----  
-----  
-----

Ofruesi i Shërbimeve Postare i regjistruar për ofrimin e shërbimeve postare të mësipërme, i cili operon nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm, është i detyruar të zbatojë termat dhe kushtet e parashtruara në Rregulloren e Autorizimit të Përgjithshëm dhe dispozitat e Ligjit Nr. 46 datë 7.05.2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”.

Në faqen e internetit AKEP publikon një regjistër të përditësuar i të gjithë Ofruesve të Shërbimeve Postare të cilët kanë njoftuar ofrimin e shërbimeve postare që nuk përfshihen në shërbimin universal postar, duke përfshirë informacionin mbi llojet e shërbimeve që ata ofrojnë.



**A K E P**

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE  
ELEKTRONIKE DHE POSTARE

## Qëndrimi i AKEP për komentet e dërguara gjatë Këshillimit Publik

### **Rregullore për Autorizimin e Përgjithshëm për Ofrimin e Shërbimeve Postare**

**Nëntor 2015**

Bazuar në Ligjin Nr.46, datë 7.5.2015 “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 2621, datë 08.10. 2015 “Për Miratimin për Këshillim Publik të dokumentit “Rregullore për Autorizimin e Përgjithshëm për Ofrimin e Shërbimeve Postare””, AKEP kreu një Këshillim Publik me palët e interesuara.

Procesi i këshillimit publik u zhvillua nga data 08.10.2015 deri në datën 08.11.2015.

Në përfundim të afatit të Këshillimit Publik janë administruar komentet e dërguara nga Ofruesi i Shërbimit Universal “A” sh.a., me shkresën nr.3771, datë 06.11.2015, (Prot. në AKEP me nr.1254/15, date 09.11.2015) “Mendime mbi dokumentin “Rregullore për Autorizimin e Përgjithshëm për Ofrimin e Shërbimeve Postare”” dhe Ofruesi i Shërbimit Postar “B” derguar me email në adresën [info@akep.al](mailto:info@akep.al) në datë 09.11.2015 dhe datë 10.11.2015.

Më poshtë paraqiten komentet e Ofruesit të Shërbimit Universal “A” sh.a. dhe B si dhe qëndrimi i AKEP mbi këto komente.

## **1. Koment: Neni 4 “Termet dhe përkufizimet”**

### **1.1 B – Koment për nenin 4 “Termet dhe përkufizimet”.**

- a) *Është shtuar pika 10 pasi është dokument i rendësishëm që duhet të qartësohet si term.*
- b) *Është shtuar pika 11 mbi Termet dhe Kushtet e Transportit të Ofruesit të Shërbimit Postar.*

#### ***Pika 10:***

***Dokument Shoqërues i objektit postar:*** *Është dokument që shoqëron një objekt postar nga pranimi deri në dorëzim. Gjithashtu si term i njohur me emërtimin Fature Shoqëruese dhe nderkombëtarisht Way Bill ose Air Way Bill, shkurtimisht AWB. Përmban të dhënat e kërkuara e të lidhura me objektin postar. Përgjegjës për plotësimin korrekt të këtij dokumenti është dërguesi.*

#### ***Pika 11:***

***Termet dhe Kushtet e Transportit:*** *Ofruesi i shërbimit postar, në kushtet dhe termet e përgjithshme të transportit përcakton rregullat kryesore për tu ndjekur nga përdoruesi referuar doganave, eksportit dhe importit. Përcakton rregullat dhe mallrat të papranueshme në transport si dhe rregullat në rastet kur objekti postar nuk mund të dorëzohet në destinacionin e mbërritur. Përcakton rregullat e inspektimit të objektit postar, mënyra e llogaritjes së pagesës për transportin, si edhe përgjegjësitë dhe limitet e përgjegjësisë të ofruesit të shërbimit postar.*

### **1.2 Qëndrimi i AKEP mbi komentin e B.**

AKEP, me qënë se komentet e dhëna nga B për nenin 4 kanë për qëllim plotësimin e këtij neni duke shtuar pikën 10 dhe pikën 11, merr në konsideratë sugjerimet e sipërpërmendura, të cilat do të pasqyrohen në Rregullore.

## **2. Koment: Neni 9 “Karakteristikat e objekteve postare”**

### **2.1 A – Koment per nenin 9.**

**Kreu II, Neni 9 pika 1.2,5,6 dhe 7 “Karakteristikat e objekteve postare” të formulohen si më poshtë vijon:**

**Pika 1.** *Karakteristikat e objekteve postare do të përfshijnë dimensionet, përmbajtjen, adresimin, paketimin dhe mbylljen, në përputhje me dispozitat e akteve të Bashkimit Universal Postar për operatorët anëtare të tij, si dhe rregullave të operatorëve të tjere postar në Republikën e Shqipërisë.*

**Pika 2.** *Objektet e korrespondencës përmbajnë materiale të shkruara ose të shtypura, dhe pakot postare përmbajnë mallra.*

**Pika 5.** *Adresa është informacioni që tregon qartë marrësin e objektit postar. Adresimi i objekteve postare do të thotë vendosja e adresës së marrësit në objektin postar. Në rast të objekteve postare që kërkojnë dokument të pranimit/shoqërimit, dërguesi duhet të vendosë adresën e tij/saj në objektin postar në mënyrë të tillë që të mos mund të fshihet pa lënë gjurmë të dukshme në objektin postar.*

**Pika 6.** *Ofruesi i shërbimit postar, në kushtet dhe termat e përgjithshme për ofrimin e shërbimit postar, duhet të përcaktojë në detaje karakteristikat e objekteve postare që do të pranohen për transport brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me dispozitat e akteve të Bashkimit Universal Postar, për operatoret anëtare të tij, si dhe rregullave të operatorëve të tjerë postar në Republikën e Shqipërisë.*

**Pika 7.** *Ofruesi i shërbimit postar, në kushtet dhe termat e përgjithshme për ofrimin e shërbimit postar, duhet të përcaktojë në detaje karakteristikat e objekteve postare që nuk pranohen për transport ndërkombëtar, në përputhje me dispozitat e akteve të Bashkimit Universal Postar, për operatorët anëtare të tij, si dhe rregullave të operatorëve të tjerë postar në Republikën e Shqipërisë.*

### **2.2 B – Komente per nenin 9.**

a) *UPU është organizatë e Ofruesve të Shërbimit Postar Ndërkombëtar ku aderohen vullnetarisht Ofrues të Shërbimit Postar. Ofruesit e Shërbimit Postar mund të mos jënë anëtarë të kësaj organizate dhe ndjekin rregullat kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe operojnë sipas Termave dhe Kushteve të tyre. Nuk limitohen apo kanë detyrim të referohen vetëm në rregullat e UPU. Më parë UPU ka patur vende/shtete anëtarë pasi Ofruesit Postare ishin vetëm të kufizuar në ofruesit publikë, përgjithësisht monopol. Sot nuk ka shtete anëtare por Ofrues Shërbimesh Postare. Shumë nga orientimet, limitet, llojet e shërbimit kanë të bëjnë vetëm me Ofruesit Publik (Postave) të Shërbimeve dhe rregulla që rregullojnë marrëdhënjet ndërmjet tyre, duke marrë parasysh infrastrukturen e tyre etj.*

*Për këtë arsye nuk do të përmendet detyrimi/detyrimet ndaj UPU, por duhet të shtohet pika 8 me tekstin si më poshtë.*

- b) Duhet të qartësohet nëse bëhet fjalë vetëm për objektin (dërgesën) si duhet të jetë, apo për dokumentin shoqërues (çfarë duhet të ketë në përshkrim) që normalisht quhet *Fatura Shoqeruese e objektit postar*. Normalisht përshkrimi nuk bëhet ose jo domosdoshmërisht bëhet i shkruar mbi objektin sugjeroj ndryshimet si më poshtë.
- c) Ka disa ndryshime ndërmjet fjalive që une sugjeroj që janë të domosdoshme për tu vendosur. I plotë si më poshtë:

### 2.3 Bazuar në komentet e mësipërme B ka bërë këtë formulim për pikat e nenit 9:

#### Neni 9

##### *Karakteristikat e objekteve postare*

1. *Karakteristikat e objekteve postare do të përfshijë dimensionet, përmbajtjen, adresimin, paketimin dhe mbylljen.*
2. *Objektet e korrespondencës përmbajnë materiale të shkruara ose të shtypura, dhe pakot postare përmbajnë mallra dhe objekte.*
3. *Paketimi i objekteve postare do të thotë vendosja e përmbajtjes së objektit postar në paketimin e duhur, në përputhje me përmbajtjen e objektit postar, llojin e shërbimit të zgjedhur, kushtet dhe kohëzgjatjen e transportit. Dërguesi është përgjegjës për paketimin e përshtatshëm të objekteve postare.*
4. *Mbyllja e objekteve postare do të jetë e tillë që të mbrojë konfidencialitetin e përmbajtjes së objektit postar dhe të parandalojë qasjen në përmbajtjen e këtij objekti pa dëmtuar dukshëm paketimin. Dërguesi është përgjegjës për mbylljen e objekteve postare.*
5. *Adresa është informacioni që tregon qartë marrësin e objektit postar. Adresimi i objekteve postare do të thotë vendosja e adresës së marrësit në objektin postar ose në dokumentin shoqërues së objektit postar. Në rast të objekteve postare që kërkojnë vërtetim të pranimit, dërguesi duhet të vendosë adresën e tij/saj në objektin postar në mënyrë të tillë që të mos mund të fshihet pa lënë gjurmë të dukshme në objektin postar. Dërguesi është përgjegjës për vendosjen e adresës së marrësit në mënyrë të qartë në objektin postar apo në dokumentin shoqërues të objektit postar. Dërguesi është përgjegjës për plotësimin e rregullt të dokumentacionit të kerkuar konform rregullave të transportit ndërkombëtar.*
6. *Ofruesi i shërbimit postar, në kushtet dhe termat e përgjithshme për ofrimin e shërbimit postar të publikuara prej tij, duhet të përcaktojë karakteristikat e objekteve postare që do të pranohen për transport, mallrat të papranueshme për transport, si dhe limitet e përgjegjësisë.*
7. *Ofruesi i shërbimit postar në kushtet dhe termat e përgjithshme të transportit duhet të përcaktojë karakteristikat e objekteve postare për transport ndërkombëtar, rregullat kryesore për tu ndjekur nga përdoruesi referuar doganave, eksportit dhe importit. Përcakton rregullat dhe mallrat të papranueshme në transport si dhe rregullat në rastet kur objekti postar nuk mund të dorezohet në destinacionin e mbërritur, si edhe limitet e përgjegjësisë.*
8. *Ofruesi i shërbimit postar mund të ndjekë përcaktimet e dispozitat e akteve të Bashkimit Universal Postar (UPU) nëse është anëtar i tij.*

### 2.4 Qëndrimi i AKEP: Mbi komentet për nenin 9

AKEP, me qënë se komentet e dhëna nga A dhe B kanë për qëllim saktësimin dhe riformulimin e pikave të mësipërme, merr në konsideratë në përgjithësi sugjerimet e sipërpërmendura, të cilat do të pasqyrohen në Rregullore sipas riformulimit të dhënë nga B në të cilën përfshihen dhe disa komente të dhënë nga A, duke bërë saktësimin në përmbajtjen e tyre në referencë me përcaktimet e ligjit 46/2015, kryesisht të nenit 34.

Për këtë:

Pika 8 e propozuar nga B, riformulohet sipas përcaktimit të nenit 34 pika 1 të Ligjit 46/2015, me përmbajtje si më poshtë:

**Pika 8 e nenit 9:**

*Ofrimi i shërbimeve postare bëhet në përputhje me standardet e harmonizuara europiane dhe standardet ndërkombëtare për shërbimet postare, të përcaktuara nga UPU-ja dhe rregullave të përcaktuara në legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar për transportin e objekteve postare.*

Sa më sipër:

Në nenin 26 “Rrjeti postar i ofruesit të shërbimit postar”, të Rregullores, në referencë me pikën 2 të nenit 34 të Ligjit 46/2015, të shtohet pika 5 më përmbajtje si më poshtë:

**Pika 5 e nenit 26:**

*Në rrjetin postar mund të vendosen vetëm pajisje që kanë karakteristika teknike, sipas standardeve të harmonizuara e të miratuara nga organizmat ndërkombëtarë, ku Republika e Shqipërisë aderon.*

**3. Koment: Neni 19 “Shërbimet postare ekspres”**

**3.1 B - Koment (ka riformuluar nenin 19 të Rregullores)**

**Neni 19**

***Shërbimet postare ekspres***

1. *Shërbimet postare ekspres do të konsiderohen shërbime postare që nuk bëjnë në pjesë në shërbimin universal postar.*

*“Shërbim ekspres” është shërbimi i shpërndarjes “derë me derë”, të dokumentave, pakove dhe mallrave, të regjistruar dhe të gjurmueshme në mënyrë elektronike nga klientet në mënyrë të pavarur deri në dorëzimin e objektit postar apo plotësimin e shërbimit për objektin postar, si për objektet postare brenda vendit edhe ato ndërkombëtare, të dorëzimit në kohën më të shkurtër të mundëshme, me kohë të përcaktuar.*

2. *Një shërbim postar do të konsiderohet si shërbim ekspres atëhere kur plotëson kërkesat e mëposhtme:*
  - a) *Shpërndarja dhe dorëzimi standard i një objekti postar të postës së brendëshme në rastin kur dërguesi dhe marrësi janë brenda teritorit të Shqipërisë duhet të bëhet ditën tjetër të punës pas pranimit të objektit postar. Ofruesi i shërbimit postar duhet*



- të ketë të publikuar kohën tranzite të dorëzimit sipas vendeve, përfshirë edhe kohën tranzite të dorëzimit në vendet ku dorëzimi nuk realizohet brenda ditës tjetër të punës. Koha standard e dorëzimit e publikuar matet për rastet kur dorëzimi është i mundshëm dhe nën kontrollin e ofruesit të shërbimit postar.
- b) Shpërndarja dhe dorëzimi i një objekti postar në rastin kur dërguesi është jashtë territorit të Shqipërisë dhe marrësi brenda territorit të Shqipërisë duhet të bëhet brenda ditës tjetër të punës, pas mbritjes së tij në Republikën e Shqipërisë. Koha standard e dorëzimit matet për rastet kur dorëzimi është i mundshëm dhe nën kontrollin e ofruesit të shërbimit postar. Ditët e pushimit javor si edhe ditët e pushimit të festave zyrtare sipas shteteve apo festave lokale në vendin e destinacionit apo origjines nuk llogariten në kohën e dorëzimit.
- c) Shërbimi postar është identifikuar në mënyre të qartë si shërbim postë-ekspres nga pranimi deri në dorëzim të objektit postar, i përfshirë në Termat dhe Kushtet e shërbimit.
- d) Shërbimi ekspres përmban një kohë të paracaktuar të dorëzimit.
- e) Shërbimi ekspres ndërkombëtar përmban një kohë të paracaktuar dhe të publikuar të dorëzimit sipas produktit apo llojit të shërbimit. Koha e dorëzimit duhet të jetë e publikuar dhe lehtësisht i aksesueshëm për publikun në pikat e pranimit të dërgesave. Koha tranzit e dorëzimit matet me ditë pune sipas shteteve të destinacionit në rastin e eksportit apo shteteve të origjinës në rastin e importit. Koha standard e dorëzimit është për të gjitha rastet kur dorëzimi është i mundshëm dhe nën kontrollin e ofruesit të shërbimit postar.
- f) Shërbimi postar përmban trajtimin e prioriteteve, ndjekjen dhe kontrollin menaxherial;
- g) Lejimin e gjurmimit dhe ndjekjes elektronike të objektit postar nga përdoruesi i shërbimit “end-to-end” si për objektet postare brenda vendit ashtu edhe për ato jashtë vendit. Gjurmimi duhet të jetë i plotë nga momenti i pranimit deri në momentin e dorëzimit apo edhe rastet kur shërbimi për objektin postar konsiderohet i plotësuar.
- h) Ofruesi i shërbimit postar duhet të ketë të publikuara dhe të aksesueshme lehtësisht për publikun, minimalisht në zyrat e tij të pranimit të objekteve postare, produktet dhe shërbimet standard të shërbimit ekspres, kohën e paracaktuar të dorëzimit si edhe çmimet përkatëse. Ofruesi i shërbimit postar ekspres duhet të publikojë përshkrimin dhe pagesat përkatëse shtesë që bëhen mbi pagesat për çmimin e shërbimit standard ekspres të cilat janë të lidhura me karakteristika të veçanta të objekteve postare që kërkojnë trajtim të veçantë administrativ dhe përpunues, shërbime për destinacione apo origjina të veçanta, si edhe pagesa për kosto shtesë të veçanta.
- i) Shërbime të tjera me vlerë të shtuar mbi ato shërbime që përfshihen në shërbimin standard ekspres, duke përfshirë mundësinë e një çmimi premium sipas llojit të shërbimit me vlerë të shtuar.
- j) Në qoftë se një ofrues të shërbimit postar është i mendimit se megjithëse shërbimi që dëshiron të ofrojë nuk përfshihet në përcaktimet e mësipërme të shërbimit postë-ekspress, por ai mund të konsiderohet se nuk bën pjesë në shërbimin universal postar, mund të dërgojë argumentat e tij të detajuara në AKEP për shqyrtim. AKEP, bazuar në përcaktimet e Rregullores për shërbimin universal postar, shprehet në se ky shërbim është ose jo shërbim postë-ekspres.

### **3.2 Qëndrimi i AKEP: Mbi komentet e nenit 19**



1. Përkufizimi i shërbimit ekspres do të ngelet i formuluar sipas përcaktimit në pikën 28 të nenit 3 të Ligjit 46/2015.

AKEP mer ne konsideratë saktësimet dhe përgjithësisht riformulimet e bëra nga B për pikat (a) deri ne (j), të cilat do të pasqyrohen në rregullore. Në pikën a dhe pikën b është shtuar detyrimi që ka ofruesi i shërbimit postar për përcaktimin e rasteve të pamundësisë të dorëzimit të objektit postar brenda kohës të përcaktuar, të cilat i publikon në termat dhe kushtet e përgjithshme të ofrimit të shërbimit postar.

#### **4. Koment: Neni 20 “Shërbimet postare ekspres me vlerë të shtuar”**

##### **4.1 A - Koment**

##### **Kreu IV - Neni 20 pika 2 të formulohet si më poshtë vijon ;**

**Pika 2.** Llojet më të përhapura të shërbimit me vlerë të shtuar mund të përfshijnë një ose disa nga shërbimet suplementare të mëposhtme:

- a) *Garancia e dorëzimit të objektit postar në një datë të caktuar;*
- b) *Dorëzimi i dërgesave postare “Personalisht” tek marrësit;*
- c) *Mundësi për të ndryshuar adresën e destinacionit dhe rrugën që do të ndiqet për dorëzimin e dërgesës postare;*
- d) *Shërbim i personalizuar për klientin.*
- e) *Shërbimi i arkëtimit të vleres së objektit postar nga marrësi për llogari të dërguesit.*
- f) *Dokument i dorëzimit të objektit postar të nënshkruar nga marrësi(POD)*

##### **4.2 B - Koment (ka riformuluar nenin 20 të Rregullores)**

##### *Neni 20*

##### *Shërbimet postare ekspres me vlerë të shtuar*

1. *Shërbimet ekspres me vlerë të shtuar janë ato shërbime të cilësuar si vlerë e shtuar për përdoruesin.*
2. *Ofruesi i shërbimit postar duhet të ketë të publikuara dhe të aksesueshme lehtësisht për publikun, minimalisht në zyrat e tij të pranimit të objekteve postare, produktet dhe shërbimet me vlerë të shtuar të shërbimit ekspres si edhe çmimet përkatëse.*
3. *Shërbimet me vlerë të shtuar mund të përfshijnë një ose disa nga shërbimet e mëposhtme:*
  - a) *Dorëzim brenda një ore të ditës të përcaktuar dhe me Garanci për Kthimin e Pagesës Shtesë në rast mosrealizimi sipas kushteve të përcaktuara, të tilla si Përpara orës 9:00, Përpara orës 10:00, Përpara orës 12:00.*
  - b) *Tërheqje apo dorëzim të objektit postar në ditët e pushimit.*

- c) *Siguracion i objektit postar. Siguracioni bëhet për një mbulim të plotë të vlerës në rast humbje apo dëmtimi të objektit postar sipas vlerës së deklaruar dhe kushteve të sigurimit të objektit postar.*
- d) *Tërheqje apo dorëzim i dedikuar kur objekti postar ka specifika të përcaktuara dhe shërbimi normal nuk është i mjaftueshëm.*
- e) *Paketimi. Paketim brenda një game standarte të paketimit të ofruesit të shërbimit.*
- f) *Administrimi dhe pagesa e detyrimeve të taksave e tatimeve nga ofruesi i shërbimit për lehtësi të dërguesit, apo një pale të tretë, kur sipas termave të tregëtimit nuk i janë lenë marrësit për të paguar, apo në rastet kur marrësi për lehtësi administrimi ngarkon ofruesin e shërbimit për të paguar.*
- g) *Terheqje apo dorëzim vonë. Shërbim i kërkuar jashtë orarit standart, jo të zakonshëm të punës.*
- h) *Firma e dorëzimit. Kur përdoruesi kërkon nga ofruesi i shërbimit një kopje të firmës së marrësit të objektit postar të dërguar në mënyrë elektronike apo kopje të printuar si provë e dorëzimit të dërgesës në destinacion.*
- i) *Trajtimi dhe transportimi i substancave dhe mallrave të klasifikuara si të rrezikshme në transportin ajror apo tokësor sipas përcaktimeve të organizatave botërore përkatëse.*
- j) *Shërbime doganore apo administrim të shërbimeve dhe dokumentacionit doganor.*

### **4.3 Qëndrimi i AKEP: Mbi komentet e nenit 20**

AKEP, me qënë se komentet e dhëna nga A dhe B kanë për qëllim saktësimin dhe plotësimin e pikave të mësipërme, merr në konsideratë sugjerimet e sipërpërmendura, të cilat do të pasqyrohen në Rregullore sipas riformulimit të dhënë nga B ku do të përfshihen dhe komente të veçanta të dhëna nga A.

## **5. Koment: Neni 23 “Kërkesat Thelbësore për ofrimin e shërbimit postar”**

### **5.1 A – Komentet e mëposhtme për nenin 23.**

**Neni 23 pika a) paragrafi II , pika c) “Kërkesat Thelbësore për ofrimin e shërbimit postar”, të formulohet si më poshtë:**

#### **Pika a) paragrafi II**

- *Kërkesat/kushtet e paketimit të objekteve postare (të përshtatshme për peshën, formën, llojin – natyrën e objektit, të thyeshme, materiale biologjike, radioaktive, të çmuara etj...);*

**Pika c)** *Mos lejimin e dërgimit të objekteve të ndaluara me ligj ose të konsideruara të rrezikshme në bazë të ligjislacionit kombëtar ose ndërkombëtar ose që, për natyrën e tyre ose ambllazhimit, mund të përbëjnë një dëm mbi njeriun, ambjentin ose për pakot e tjera që janë për tu transportuar sipas rregullave të UPU-së, për operatorët postar anëtarë të saj, si dhe rregullave të operatorëve të tjerë postar në Republikën e Shqipërisë.*

### **5.1 B – Koment (ka riformuluar pike c te nenit 23)**

*Mos lejimin e dërgimit të objekteve të ndaluara me ligj ose të konsideruara të rrezikshme në bazë të ligjislacionit kombëtar ose ndërkombëtar ose që, për natyrën e tyre ose ambllazhimit, mund të përbëjnë një dëm mbi njeriun, ambjentin ose për pakot e tjera që janë për tu transportuar sipas rregullave të organizatave nderkombetare dhe UPU (per ofruesit anetare).*

Për piken c të nenit 23 B jep këtë koment:

*Nuk është UPU, por IATA , organizata të UN, konventa, etj që nxjerrin rregullat për zbatim të detyrueshëm , plus rregulla shtesë lokale që mund të ketë.*

### **5.2 Qëndrimi i AKEP: Mbi komentet e nenit 23**

1. AKEP, për paragrafin e dytë të pikes a mer në konsideratë riformulimin e berë nga A, i cili ndryshon dhe bëhet si më poshtë:
  - *Kërkesat/kushtet e paketimit të objekteve postare (të përshtatshme për peshën, formën, llojin – natyrën e objektit, të thyeshme, materiale biologjike, radioaktive, të çmuara etj...);*
2. AKEP, per piken c te nenit 23 jep këtë sqarim:

Ofruesit e shërbimeve postare, pavaresisht janë ose jo anëtarë të UPU, nuk duhet të transportojnë objekteve të ndaluara me ligj ose të konsideruara të rrezikshme në bazë të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar.

Sa më sipër Pika c, duke marrë në konsideratë komentin e B, ndryshohet duke hequr termat ... **dhe UPU.**, dhe formuluar si më poshte:

*Mos lejimin e dërgimit të objekteve të ndaluara me ligj ose të konsideruara të rrezikshme në bazë të ligjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar ose që, për natyrën e tyre ose ambllazhimit, mund të përbëjnë një dëm mbi njeriun, ambjentin ose për pakot e tjera që janë për tu transportuar sipas rregullave të organizatave ndërkombëtare.*

## **6. AKEP - Koment për Formularin e Njoftim Regjistrimit – Pjesa B e Aneksit A.**

B, për Njoftim Regjistrimin e subjekteve që kërkojnë të ofrojnë shërbime postare që nuk bëjnë pjesë në shërbimin universal postar nën regjimin e autorizimit të përgjithshëm, propozon versionin që në formularin e aplikimit (Pjesa B e Formularit) të jetë e persërituar dhe specifikuar

me formularë të veçantë për çdo shërbim postar, në të cilët janë të përcaktuar paraprakisht emertimet e shërbimeve postare që dëshiron të ofrojë subjekti.

AKEP, konsideron si lehtësisht të aksesueshem modelin e një formulari të përgjithshëm (Pjesa B e Formularit), i cili duhet të plotësohet nga subjekti aplikues për çdo shërbim që kërkon të ofrojë duke përcaktuar vetë subjekti në formular emrin e shërbimit që dëshiron të ofrojë si dhe të shënojë vetem të dhënat që i përkasin këtij shërbimi, të cilat janë të evidentuara në këtë formular. Në këtë rast Pjesa B e Formularit përsëritet vetëm për shërbimin/et që subjekti kërkon të ofrojë.

Formulari i Njoftim Regjistrimit është pjesë e Rregullores.